

Barometri i qasshmërisë së faqeve të internetit të institucioneve publike

03.05.2023

1	Përmbledhje.....	2
2	Arsyetimi i studimit.....	2
3	Institucionet publike të studuara.....	3
4	Çështjet Kritike.....	5
4.1	Çështjet kritike vizuale.....	5
4.2	Çështjet kritike vizuale dhe motorike.....	5
4.3	Çështjet kritike motorike.....	6
4.4	Çështjet kritike kognitive.....	6
5	Identifikimi i defekteve (Bugs).....	7
5.1	Çështjet kritike vizuale.....	7
5.1.1	Ngjyrat e sfondit dhe të planit të parë nuk kanë mjaftueshëm raport të kontrastit.....	7
5.1.2	ID-të e ARIA nuk janë unike.....	7
5.1.3	Elementet e titujve nuk janë në një rend zbritës.....	8
5.1.4	Çaktivizimi i funksionit të zmadhimit.....	8
5.1.5	Linqet nuk kanë një emër të dallueshëm.....	9
5.1.6	"[user-scalable=""jo"] përdoret në <meta name=""viewport"">elementi ose atributi [maximum-scale] është më pak se 5.".....	9
5.1.7	<html>elementi nuk ka një atribut [lang].....	10
5.1.8	Elementet e formularit nuk kanë etiketa të lidhura.....	10
5.2	Çështjet vizuale dhe motorike.....	11
5.2.1	Elementet e imazhit nuk kanë attribute [alt].....	11
5.2.2	Elementet <frame> ose <iframe> nuk kanë titull.....	11
5.2.3	Dokumenti nuk ka një element <title>.....	12
5.2.4	Vlerat kyçe të qasjes nuk janë unike.....	12
5.2.5	Faqja nuk përmban një titull, anashkalim të linkut (skip link) ose rajoni i pikës së referimit. 13	
5.3	Çështjet motorike.....	13
5.3.1	Një përdorues nuk është në gjendje të ngrijë skedarët GIF dhe objekte të tjera lëvizëse. 13	
5.4	Çështjet kognitive.....	14
5.4.1	Butonat nuk kanë një emër të qasshëm.....	14
6	Përfundimi.....	15

1 Përmbledhje

Ky raport paraqet gjetjet e studimit të qasshmërisë së ueb faqeve të institucioneve publike, studim ky i kryer nga Shoqata Profesionale e Informaticientëve të Kosovës (SHPIK). Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë nivelin e përmbushjes së standardeve ndërkombëtare për ueb faqe, me fokus të veçantë në sigurimin e qasjes së barabartë për persona me aftësi të kufizuara.

Ky raport ofron detaje lidhur me nivelin e përmbushjes së këtyre standardeve nga institucionet publike kyçe vendore si dhe ofron rekomandime për përmirësimin e ueb faqeve, ashtu që ato të jenë në përputhje me standardet për sigurimin e qasshmërisë së faqeve të internetit në institucionet publike.

Bazë e studimit kanë qenë 66 faqe të internetit të institucioneve publike (ministri, komuna, shërbime publike, etj.).

Studimi është fokusuar në hulumtimin e një mori kriteresh relevante, të ndara në katër kategori kryesore:

- Vizuale
- Motorike
- Vizuale dhe motorike dhe
- Kognitive.

Këto kategori janë ndarë më tej në 15 nën-kategori, 8 për vizuale, 5 për vizuale dhe motorike, 1 për motorike dhe 1 për kognitive.

Nga gjithsej 66 ueb faqet e institucioneve publike, që janë testuar, studimi ka zbuluar se shumica dërrmuese e tyre, NUK i plotësojnë kriteret ndërkombëtare të qasshmërisë.

Duke marr parasysh faktin se për shumicën e personave me aftësi të kufizuar, qasja në informata online dhe shërbime online është jetike dhe ndoshta e vetmja mënyrë e informimit por edhe përtej informimit për shkak të mungesës së shtigjeve për të verbër, etj., atëherë, mund të konkludojmë se personat me aftësi të kufizuar në Kosovë janë të privuar nga e drejta e garantuar për qasje të barabartë në informata dhe shërbime publike.

Raporti ofron rekomandime për përmirësimin e qasshmërisë dhe promovimin e përfshirjes së plotë të individëve me aftësi të kufizuara në shoqëri.

2 Arsyetimi i studimit

Qasshmëria në faqet e internetit është thelbësore për të siguruar që të gjithë individët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, të kenë qasje në informacione dhe shërbimet e ofruara nga institucionet publike.

Kosova ka ratifikuar Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2012, e cila kërkon që shtetet të promovojnë përfshirjen e plotë të individëve me aftësi të kufizuara në shoqëri. Si e tillë, është thelbësore që institucionet publike të ofrojnë faqe interneti të qashme për të plotësuar nevojat e të gjithë përdoruesve.

3 Institucionet publike të studiuara

Nga 66 ueb faqet që u studiuuan, vetëm 7 arritën rezultatet e dëshiruara për sa i përket qasshmërisë. Ueb faqet që arritën rezultatet e dëshiruara janë: Ministria e punëve të brendshme, Kompania rajonale ujësjellësit, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Administrata Tatimore, Shpik, E-Kosova, dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Pjesa tjetër e platformave, nuk arritën t’i përmbushin standardet e qasshmërisë. Për nga niveli i përmbushjes së kriterëve të qasshmërisë, ueb-faqet e hulumtuara i kemi ndarë në tri kategori:


- Të gjelbërta – i plotësojnë kriteret (7 ueb faqe)
- Të verdha – nuk i plotësojnë kriteret, respektivisht i plotësojnë pjesërisht (20 ueb faqe)
- Të kuqe – nuk i plotësojnë pjesën dërrmuese të kriterëve të qasshmërisë, respektivisht janë të pa qasshme për personat me aftësi të kufizuar (39 ueb faqe)

Emri i ueb-faqes / institucionit	Rezultati
Ministria e Punëve të Brendshme	85%
Administrata Tatimore e Kosovës	75%
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina"	75%
Instituti Albanologjik-Prishtinë	75%
Shpik	73%
E-Kosova	71%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	70%
Institucioni i Avokatit të Popullit	59%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	59%
Instituti Pedagogjik i Kosovës	59%
Ministria e Ekonomisë	58%
Trusti	56%
Prishtina Parking	56%
Qendra e Studentëve	56%
Policia e Kosovës	55%
Raiffeisen Bank	55%
Agjencia e Statistikave të Kosovës	55%
Prishtina International Airport Adem Jashari	54%
Ministria e Shëndetësisë	53%
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	53%
Zyra e Kryeministrit	52%
Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave	52%
Ministria e Mbrojtjes	52%
ProCreditBank	51%
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	51%
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	50%
Posta	50%
Ministria për Komunitet dhe Kthim	49%

Paysera	48%
Ministria e Administratës Publike	48%
KESCO	47%
Zyra Kombëtare e Auditimit	47%
Shoqata e Bankave të Kosovës	46%
Banka Qendrore e Kosovës	46%
Kosovo Intelligence Agency	46%
Vala – Telecom Company	45%
Komuna e Pejës	45%
Komuna e Mitrovicës	45%
Komuna e Ferizajit	45%
Hekurudha e Kosovës	45%
Komuna e Gjakovës	44%
Komuna e Gjilanit	44%
Komuna e Prizrenit	44%
BPB	43%
Banka Kombëtare Tregtare	42%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	42%
Dogana e Kosovës	41%
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	40%
Prishtina Online	39%
Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik	33%
Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	33%
Ministria e Financave	33%
Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Edukimit	32%
RTKLive	32%
Banka Ekonomike	32%
Ministria e Bujqësisë, Pyltërisë dhe Zhvillimit Rural	32%
Universiteti i Prishtinës - Hasan Prishtina	30%
Biblioteka Kombëtare e Kosovës	30%
Stacioni i Autobusëve Prishtinë	29%
Universiteti i Prishtinës- Fakulteti i Mjekësisë	29%
Ministria e Drejtësisë	25%
Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	23%
Komuna e Prishtinës	22%
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	15%
Gjykata Kushtetuese	14%
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	13%

4 Çështjet Kritike


Pas studimit të 66 ueb faqeve të ndryshme, u zbulua se vetëm 7 prej tyre kanë arritur përmbushjen e plotë të kriterëve të qasshmërisë. Kjo do të thotë se vetëm 11% e platformave të studiuara janë plotësisht të qasshme, ndërsa 20 prej tyre që do të thotë 30% janë të pjesërisht të qasshme, kurse pjesa e mbetur 59% ueb faqeve të institucioneve publike, pjesë e studimit, janë të pa qasshme për personat me aftësi të kufizuara, respektivisht kanë probleme serioze të qasshmërisë.



4.1 Çështjet kritike vizuale

Studimi zbuloi se çështjet kritike vizuale u arritën nga 14 platforma, nga 47 platforma u arritën pjesërisht dhe nga 5 platforma nuk u arritën fare. Kjo tregon se një numër i konsiderueshëm platformash kanë dështuar në përmbushjen e kërkesave të qasshmërisë në këtë kategori, gjë që përbën një pengesë për personat me dëmtime në shikim për t'ju qasur shërbimeve publike.


Çështjet kritike vizuale i referohen çështjeve që ndikojnë në aftësinë e një përdoruesi për të perceptuar dhe ndërvepruar me përmbajtjen digjitale vizualisht.



4.2 Çështjet kritike vizuale dhe motorike

Nga 66 ueb faqet e hulumtuara, vetëm 12 prej tyre i kanë përmbushur kriteret vizuale – motorike, kurse 45 sosh i arritën pjesërisht, kurse 9 ueb faqe nuk i kanë përmbushur ato.


Kjo çështje i referohet sfidave me të cilat përballen përdoruesit me dëmtime vizuale dhe motorike në qasjen e përmbajtjes digjitale.



4.3 Çështjet kritike motorike

Në kategorinë e çështjeve kritike motorike, 54 ueb faqe ishin në përputhje me kërkesat e qasshmërisë, ndërsa vetëm 12 platforma nuk përmbushën kërkesat.


Çështjet kritike motorike i referohen çështjeve që ndikojnë në aftësinë e një përdoruesi për të lundruar dhe ndërvepruar fizikisht me përmbajtjen digjitale.



4.4 Çështjet kritike kognitive

Në kategorinë e çështjeve kritike njohëse, 29 ueb faqe ishin në përputhje me kërkesat e qasshmërisë, ndërsa 37 platforma nuk i përmbushën kërkesat.

Çështjet kritike kognitive i referohen çështjeve që ndikojnë në aftësinë e një përdoruesi për të përpunuar dhe kuptuar përmbajtjen digjitale.




5 Identifikimi i defekteve (Bugs)

5.1 Çështjet kritike visuale

5.1.1 Ngjyrat e sfondit dhe të planit të parë nuk kanë mjaftueshëm raport të kontrastit.

Teksti me kontrast të ulët është i vështirë ose i pamundur për t'u lexuar nga shumë përdorues.


Pra, nga 66 platformave, 80% (d.m.th., 53 ueb faqeve) kishin hasur në këtë problem. Në të kundërt, vetëm 13 platforma u gjetën që e kishin zgjidhur me sukses këtë çështje.



5.1.2 ID-të e ARIA nuk janë unike

Kur ID-të ARIA nuk janë unike, mund të rezultojë në konfuzion dhe gabime për përdoruesit me aftësi të kufizuara që mbështeten në teknologjinë ndihmëse për të hyrë në përmbajtjen e uebit.


Nga gjithsej 66 ueb faqe që u vlerësuan, është evidentuar se 30 prej tyre kanë çështjen e ID-ve jo unike ARIA në elementët e faqeve të internetit.



5.1.3 Elementet e titujve nuk janë në një rend zbritës

Çështja e "Elementët e titullit që nuk janë në një rend zbritës vijues" i referohet një problemi në qasje në ueb ku etiketat e titujve (H1, H2, H3, etj.) të përdorura në një faqe interneti nuk janë të renditura në një hierarki logjike dhe sekuenciale.


Nga 66 platformat që u vlerësuan, është evidentuar se 35 prej tyre kanë këtë problematikë.



5.1.4 Çaktivizimi i funksionit të zmadhimit

Çështja e "çaktivizimit të funksionit të zmadhimit" i referohet një problemi në qasjen në ueb, ku faqja e internetit është projektuar në një mënyrë që ndalon përdoruesit të zmadhojnë ose zvogëlojnë duke përdorur funksionin e zmadhimit të shfletuesit të tyre.

Nga 66 ueb faqe që u vlerësuan, është evidentuar se 25 prej tyre kanë çaktivizuar funksionin e zmadhimit në faqet e tyre të internetit.



5.1.5 Linqet nuk kanë një emër të dallueshëm

Çështja e "linqeve që nuk kanë një emër të dallueshëm" i referohet një problemi ku teksti ose imazhi i hiperlidhjes nuk është mjaft përshkrues për të informuar përdoruesit për destinacionin ose qëllimin e përmbajtjes së lidhur.


Nga 66 ueb faqet e studiuara 58 prej tyre kanë problemin e linqeve që nuk kanë një emër të dallueshëm, kurse vetëm 8 prej ueb faqeve e kanë tejkaluar këtë problem. Kjo do të thotë se afërsisht 12% e ueb faqeve të vlerësuara e kanë trajtuar me sukses këtë çështje të qasshmërisë.



5.1.6 "[user-scalable=""jo"] përdoret në <meta name=""viewport"">elementi ose atributi [maximum-scale] është më pak se 5."

Çështja e përdorimit të "[user-scalable="no"]" në elementin <meta name="viewport"> ose vendosja e atributit [maximum-scale] në më pak se 5 i referohet problemit ku zhvilluesit e uebit parandalojnë përdoruesit nga zmadhimi i përmbajtjes së uebit, ose duke çaktivizuar plotësisht funksionin e zmadhimit ose duke kufizuar sasinë maksimale të zmadhimit të disponueshëm.


Nga 66 ueb faqet e vlerësuara, është evidentuar se vetëm një platformë e ka këtë problematikë, e cila përfaqëson më pak se 2% të platformave të vlerësuara.



5.1.7 <html>elementi nuk ka një atribut [lang]

Çështja e elementit <html> që nuk ka një atribut [lang] do të thotë që gjuha e faqes së internetit nuk është e specifikuar në kodin HTML.

Nga 66 ueb faqet e vlerësuara, është identifikuar se 19 platforma kanë problemin që elementi <html> nuk ka një atribut [lang], që përfaqëson 29% të platformave të vlerësuara.



5.1.8 Elementet e formularit nuk kanë etiketa të lidhura

Çështja e elementeve të formularit që nuk kanë etiketa të lidhura i referohet kontrolleve të formularit, të tilla si fushat e hyrjes dhe kutitë e kontrollit, nuk janë etiketuar siç duhet në një mënyrë që lidhet programatikisht me elementin e tyre përkatës të formës.

59 platforma kanë problemin e elementeve të formularit që nuk kanë etiketa të lidhura, që përfaqëson afërsisht 89% të platformave të vlerësuara, kurse vetëm 11% prej tyre kanë kaluar këtë çështje.




5.2 Çështjet vizuale dhe motorike

5.2.1 Elementet e imazhit nuk kanë atributet [alt]

Çështja e elementeve të imazhit që nuk kanë atributet [alt] i referohet imazheve të një faqe interneti që nuk përshkruhen siç duhet përdorimi i tekstit alternativ.


Nga 66 platformat e vlerësuara, është identifikuar se 39 platforma kanë problemin e elementeve të imazhit që nuk kanë atributet [alt], që përfaqëson afërsisht 59% të platformave të vlerësuara.



5.2.2 Elementet <frame> ose <iframe> nuk kanë titull

Çështja e elementeve <frame> ose <iframe> që nuk kanë një titull i referohet problemit ku kornizat në një faqe interneti nuk janë etiketuar siç duhet me një atribut titulli.


Nga 66 platformat e vlerësuara, është identifikuar se 50 platforma kanë problemin e elementeve të imazhit që nuk kanë atributet [alt], që përfaqëson afërsisht 76% të platformave të vlerësuara.



5.2.3 Dokumenti nuk ka një element <title>

Çështja e një dokumenti që nuk ka një element <title> i referohet një problemi ku në faqet e internetit mungon elementi i kërkuar i titullit në kodin HTML. Elementi i titullit është një pjesë e rëndësishme e faqes së internetit që shfaqet në shiritin e titullit të shfletuesit dhe ofron një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes në faqe.


Janë identifikuar se vetëm 8 platforma kanë çështjen e një dokumenti që nuk ka element <title>, që përfaqëson 12% të platformave të vlerësuara.



5.2.4 Vlerat kyçe të qasjes nuk janë unike

Çështja që vlerat kyçe të qasjes nuk janë unike është ku elementëve në një faqe u caktohet e njëjta vlerë kyçe e qasjes. Tastet e hyrjes janë shkurtores të tastierës që lejojnë përdoruesit të lundrojnë shpejt në elementë të caktuar në një faqe interneti.

Në 59 platforma të studiuara është hasur problemi e qasjes dhe vlerat e tyre nuk janë unike .




5.2.5 Faqja nuk përmban një titull, anashkalim të linkut (skip link) ose rajoni i pikës së referimit.

Çështja e një faqeje interneti që nuk përmban një titull, anashkalim të linkut ose pikë referimi është problem në qasjen në ueb që mund ta bëjë të vështirë për përdoruesit, veçanërisht ata me dëmtime shikimi ose aftësi të kufizuara motorike, të lundrojnë dhe të kuptojnë përmbajtjen e faqes.

Titujt, anashkalim të linkut dhe pikat e referimit janë të rëndësishme për përdorim për të ofruar strukturë dhe organizim në një faqe interneti. Titujt ofrojnë një hierarki të përmbajtjes, duke i lejuar përdoruesit të kuptojnë seksionet dhe nën-seksionet kryesore të një faqeje. Anashkalimi i linkut u mundëson përdoruesve të anashkalojnë përmbajtjet e përsëritura ose lundruese dhe të hidhen drejtpërdrejt në përmbajtjen kryesore të një faqeje. Rajonet pikë referimi ofrojnë një mënyrë për të identifikuar rajonet kryesore të një faqeje, të tilla si përmbajtja kryesore, navigimi ose fundi.

Nga 66 platformat e vlerësuara, është identifikuar se vetëm 2 prej tyre kanë problemin e një faqe interneti që nuk përmban një titull, një anashkalim të linkut ose një rajon për pikë referimi.



5.3 Çështjet motorike

5.3.1 Një përdorues nuk është në gjendje të ngrijë skedarët GIF dhe objekte të tjera lëvizëse

Çështja e një përdoruesi që nuk është në gjendje të ngrijë GIF dhe objekte të tjera lëvizëse në një faqe interneti i referohet mungesës së funksionalitetit për përdoruesit për të ndaluar ose vendosur në pauzë përmbajtjen e animuar, e cila mund të jetë shpërqendruese ose dërrmuese për disa përdorues, veçanërisht ata me disa lloje neurologjike ose kushtet njohëse.

Nga 66 platformat e vlerësuara, është evidentuar se 17% ose 11 prej tyre e kanë këtë problem. Ky është një numër relativisht i rëndësishëm, pasi mund të ndikojë potencialisht në një numër të konsiderueshëm përdoruesish.



5.4 Çështjet kognitive

5.4.1 Butonat nuk kanë një emër të qasshëm

Çështja e butonave që nuk kanë një emër të qasshëm i referohet një situatë ku një butoni në një faqe interneti nuk ka një etiketë ose tekst të qartë dhe përshkrues, duke e bërë të vështirë për përdoruesit me aftësi të kufizuara të kuptojnë qëllimin ose funksionin e butonit.

Nga 66 platformat e vlerësuara, është identifikuar se 36 prej tyre kanë butona pa emra të qasshme, që përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të platformave.



6 Përfundimi

Si përfundim, rezultatet e studimit theksojnë një nevojë urgjente për rritjen e pajtueshmërisë me kriteret e qasshmërisë për shumicën e uebfaqeve të institucioneve publike në Kosovë. Shumica e faqeve të internetit të vlerësuara nuk plotësonin kërkesat e qasshmërisë, duke treguar se duhet bërë më shumë punë për të siguruar që të gjithë qytetarët të kenë qasje të barabartë në informacion dhe shërbime online.

Gjetjet e studimit sugjerojnë gjithashtu se ka mungesë të mbështetjes së qasshmërisë për përdoruesit me aftësi të kufizuara në gjuhën shqipe, gjë që mund të përkeqësojë më tej sfidat e qasshmërisë. Miratimi i marrë në 2007 për sintaksën për personat aftësi të kufizuara në gjuhën shqipe nuk është përfunduar ende, duke theksuar nevojën për veprim të përsheptuar për pajtueshmërinë me qasshmërinë.

Për ta promovuar përfshirjen e plotë të individëve me aftësi të kufizuara në shoqëri, institucionet publike duhet t'i japin përparësi qasshmërisë në uebfaqe. Duke zbatuar masat e rekomanduara të qasshmërisë, institucionet publike mund të përmirësojnë qasjen në uebfaqe dhe të sigurojnë që të gjithë qytetarët të kenë qasje të barabartë në informacionin dhe shërbimet digjitale. Pra, është e domosdoshme të adresohet pajtueshmëria me qasshmërinë për të krijuar një mjedis digjital më gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë individët.